



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 134, Datë 06.06.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “TEODORI” SH.P.K. PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-S NR. 68, DATË 11.04.2022,**

**“MBI KËRKESËN E KONCESIONARIT “TEODORI” SH.P.K., PËR TRANSFERIMIN
E PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË KONCENSIONARE “TEODORI 2003”
SH.P.K., NR. 87, SERIA PV09K, DHËNË PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ZALLI I BULQIZËS” DHE HEC “TERNOVË”,
TEK SHOQËRIA “TEODORI” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 15, dhe 16, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/11 prot., datë 03.06.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e koncesionarit “TEODORI” sh.p.k, për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare “TEODORI 2003” sh.p.k, nr. 87, Seria PV09K dhënë me vendimin e Bordit nr. 83, datë 04.11.2009, për një afat 30 vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli I Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”, tek shoqëria “TEODORI” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e datës 09.05.2022, protokolluar në ERE me nr. 336/4 prot., datë 10.05.2022, shoqëria “TEODORI” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 68, datë 11.04.2022, “Mbi kërkesën e koncesionarit “TEODORI” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare “TEODORI 2003” sh.p.k., nr. 87, seria PV09K, dhënë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”, tek shoqëria “TEODORI” sh.p.k.” dhe transferimin e plotë të kësaj licence nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., me pretendimin që nuk është shoqëria koncesionare, te shoqëria “TEODORI” sh.p.k.
- Në kuptim të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 16, pika 1, të “Rregullores për organizimin, funksionimin

dhe procedurat e ERE-s”, kërkesa e shoqërisë është paraqitur në afat dhe ajo konsiderohet palë në këtë proces.

- *Shoqëria “TEODORI” sh.p.k. pretendon se në bazë të së drejtës së koncesionit, lejet dhe licencat, sic është ajo e prodhimit të energjisë elektrike, i merr dhe i përfiton vetëm shoqëria koncesionare “TEODORI” sh.p.k., ndaj ERE, me vendimin nr. 83, datë 04.11.2009, i ka dhënë licencën një shoqërie që ligjërisht nuk e përfiton këtë të drejtë, konkretisht shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., në mënyrë të jashtëligjshme, ndaj është kërkuar transferimi i licencës.*

Për sa pretenduar nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit të shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. rezulton se në nenin 4 të marrëveshjes së koncesionit të nënshkruar në zbatim të VKM-së nr. 556, datë 01.08.2003, është parashikuar se: *Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Konçesionari do të formojë Shoqërinë Konçesionare sipas ligjit Nr. 7973, datë 26.07.1995 "Për konçesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukture".*

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se, shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k. është krijuar në zbatim të marrëveshjes së koncesionit të sipërcituar dhe administratori, me vullnetin e tij të lirë ka paraqitur dokumentacionin përkatës për licencimin e kësaj shoqërie. Përveç sa më sipër, një pjesë e dokumentacionit të këtij aplikimi është njësuar me vulën e “shoqërisë koncesionare TEODORI 2003” sh.p.k.

- *Shoqëria pretendon gjithashtu se provë e re për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 68/2022, është dhe shkresa e MIE-s nr. 1726 prot., datë 21.02.2022, drejtuar shoqërisë koncesionare “TEODORI” sh.p.k. Për rrjedhojë, me këtë shkresë vetë MIE njeh si koncesionar dhe shoqëri koncesionare, shoqërinë “TEODORI” sh.p.k. dhe jo shoqërinë “TEODORI 2003” sh.p.k.*

Nga komunikimet zyrtare ndërmjet MIE-s dhe Agjensisë Kombëtare të Burimeve Ujore vërehet se këto institucione njohin si koncensiore shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k.

Shoqëria pretendon gjithashtu se provë e re janë dhe mosshlyerja e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., duke iu referuar në këtë rast shkresës së ERE me nr. 505 prot., datë 13.04.2022, për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2021.

Në lidhje me këtë pretendim konstatohet se me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 575/1 prot., datë 19.04.2022, shoqëria “TEODORI 2003” ka kthyer përgjigje në ERE në vijim të nisjes së proceduës hetimore për mosshlyerjen e pagesave të rregullimit të vitit 2021, duke dhënë informacionin përkatës mbi rrethanat që e kanë çuar këtë shoqëri në mosshlyerjen e këtij detyrimi. Në përfundim, shoqëria ka dokumentuar shlyerjen e pagesës rregullatore të vitit 2021 ndaj ERE-s dhe nuk rezulton debitor.

- *Shoqëria pretendon se provë e re janë dhe mospagesat e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. ndaj Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, dhe në mbështetje të pretendimit të saj ka depozituar në ERE shkresat për detyrimet e papaguara dhe faturat përkatëse për arkëtim.*

Për sa pretenduar, ERE nuk ka asnjë kompetencë të marrë masa ndaj një të licencuari për detyrimet që ky i licencuar ka ndaj të tretëve. Në këtë rast *organi qëndror përgjegjës*, në zbatim të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, është *Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)*. Përveç kësaj konstatohet se të gjitha shkresat e depozituara në lidhje me detyrimet përkatëse për tarifën e ujit i janë drejtuar shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., çka do të thotë se kjo shoqëri ka të drejtën e përdorimit të burimit ujor përkatës. **Sa më sipër, as ky pretendim i shoqërisë nuk qëndron dhe as nuk përbën provë të re.**

- *Shoqëria pretendon se rregullorja e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, në të cilën ERE është bazuar për të marrë vendimin nr. 68, datë 11.04.2022, për të cilin shoqëria TEODORI sh.p.k ka kërkuar rishikimin, nuk mund të shërbejë si bazë për të marrë vendime në lidhje me subjektet, pasi është në kundërshtim me nenin 119 të Kushtetutës.*

Në lidhje me këtë pretendim vlerësojmë se ERE në zbatim të nenit 20, gërma “b” dhe nenit 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet dhe procedura dhe dokumentacioni i kërkuar për transferimin e plotë apo të pjesshëm të një licence.

- Për gjithë sa më sipër pretenduar e parashtruar, rezulton se shoqëria “TEODORI” sh.p.k. nuk ka paraqitur prova të reja, të tilla që ta çojnë bordin e ERE-s të marrë një vendim të ndryshëm, ndaj kërkesa e shoqërisë për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 68, datë 11.04.2022, “Mbi kërkesën e koncesionarit “TEODORI” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare “TEODORI 2003” sh.p.k., nr. 87, Seria PV09K, dhënë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Zalli i Bulqizës” dhe Hec “Ternovë”, tek shoqëria “TEODORI” sh.p.k., duhet të rrëzohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrëzojë kërkesën e e shoqërisë “TEODORI” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 68, datë 11.04.2022, “Mbi kërkesën e koncesionarit “TEODORI” sh.p.k. për

transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncensionare “TEODORI 2003” sh.p.k., nr. 87, seria PV09K, dhënë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Zalli i Bulqizës” dhe Hec “Ternovë”, tek shoqëria “TEODORI” sh.p.k., si të pabazuar në prova të reja.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

